



KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM

Datë 24.10.2023

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 43 pika 2, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5 pika 3 të Rregullores “Mbi transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” e ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë shpall sot thirrjen për fillimin e procedurave **për plotësimin e 2 (dy) pozicioneve vakante në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier**, përmes procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele.

Subjektet të cilët kanë të drejtë të kandidojnë janë :

- a) prokurorët pranë gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm;
- b) prokurorët e komanduar;
- c) prokurorët në skemë delegimi.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë iu bën thirrje që të kandidojnë të gjithë prokurorëve që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë prokuror i Republikës së Shqipërisë;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të mos ketë qenë anëtar i Këshillit në tri vitet e fundit;
- ç) të ketë të paktën një vit përvojë profesionale në fushën përkatëse të së drejtës gjatë 5 viteve të fundit, përveç rastit të parashikuar nga neni 40, pika 2, germa “b” e ligjit për statusin.

Kandidatët që plotësojnë kushtet e sipërpërmendura i paraqesin kërkesat e tyre jo më vonë se data **07.11.2023**, ora **24:00**.

Krahas kërkesës për kandidim, kandidatët dorëzojnë pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesa për shprehjen e interesit për pozicionin e lirë të shpallur;
- b) Një jetëshkrim i përditësuar;
- c) Vetëdeklarim për mospasjen masë disiplinore në fuqi;
- ç) Vetëdeklarim për mosqenien në situatën e papajtueshmërisë ambjentale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin;
- d) Çdo dokument tjetër që e gjykon të arsyeshëm kandidati.

Aplikimet do të dorëzohen në formë elektronike në adresën: karriera@klp.al (në këtë rast të gjitha dokumentet e sipërpërmendura duhet të jenë të skanuara) ose në formë fizike, personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar në adresën: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Rruga “Ana Komnena”, godina e “Polit të Drejtësisë”, Tiranë.